



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:212134

Datë: 28.07.2022

Numri i dokumentit: 03274582

C.nr.975/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari **Besmir Juniku**, në çështjen juridike të paditësit I. Th. nga Rahoveci, të cilin e përfaqëson i autorizuari av.A. A. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S." me seli në Prishtinë, me bazë juridike – kompensim dëmi, vlera e kontestit 1,000.00 Euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë **28.07.2022** merr këtë:

A K T V E N D I M

Padia e paditësit I. Th. nga Rahoveci, në lidhje me këtë çështje juridike **KONSIDEROHET E TËRHEQUR.**

A r s y e t i m

Paditësi I. Th. nga Rahoveci, përmes të autorizuarit av.A. A. nga Prizreni pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S." me seli në Prishtinë, me bazë juridike – kompensim dëmi.

Gjykata me Aktvendimin C.nr.975/2021 të datës 09.11.2021 e ka ftuar paditësin që në afat prej 7 (shtatë) ditësh ta paguaj taksën e paraparë gjyqësore për padinë e parashtruar, me vërejtje se në rast se të njëjtën nuk e paguan do të konsiderohet se e ka tërhequr padinë.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletëkthesa se i autorizuari i paditësit me datën 12.11.2021 e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, ndërsa nuk e ka bërë pagesën e taksës së kërkuar për padinë.

Sipas Nenit 253 par. 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) është paraparë se *"në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr."*

Duke marr parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësi nuk e ka bërë pagesën e kësaj takse brenda afatit të përcaktuar, ndërsa nuk ekzistojnë

kushtet për lirimin e tij nga pagesa e së njëjtës, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtueshmëri me nenin 253.5 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.975/2021, me datë 28.07.2022.

Gj y q t a r i
Besmir Juniku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.